




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK
Dep.	
Dep.	
Nr. I faq.	03-02/3794/18
Broj stranica	
Nr. pages	
	02
	PRISHTINE
Nr. Prot.	
Br Prot	
Prot No	
Data	01.11.2018
Datum	
Date	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2018 të Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 31.10.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK-03-02-1602/18, për z. Migjen Shala, Asambleisti në Kuvendin e Komunës së Prishtinës dhe Anëtar i Kryesisë së Organizatës së Veteraneve të Luftës së UÇK-së, për shkak se ështëshmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik nr. AKK-03-02-1602/18, për z. Migjen Shala, Asambleist në Kuvendin e Komunës së Prishtinës dhe Anëtar i Kryesisë së Organizatës së Veteraneve të Luftës së UÇK-së, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korruptionit, pas pranimit të kërkesës me një informacioni nga jashtë (pala e tretë), fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Migjen Shala me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPK-03-02/1643/18). Pasi që pala ka pranuar këtë shkresë, ai është paraqitur fillimisht me telefon e pastaj është organizuar një



takim me te në ambientet e Agjencisë. Gjatë këtij takimi, zyrtari i lartë z.Shala, është njoftuar se ka pretendime se ai ushtron funksion menaxhues në OVL të UCK-së që sipas denoncuesit, bazuar në Ligjin për P.K.I. është e ndaluar. Por, vet zyrtari i lartë ka dekluar se ai është vetëm anëtar i Kryesisë së OVL të UÇK dhe se nuk ushtron asnjë funksion drejtues në këtë organizatë. Këtë e ka dëshmuar edhe me një shkresë zyrtare të datës 15.10.2018, të lëshuar nga OVL e UÇK-së, (me nr.protokoli DPK-03-02/3479/18).

“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimitarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to” (Neni 14, paragrafi 1, i Ligjit Nr.06/L-011).

Përveç kësaj, gjatë trajtimit të këtij rasti, Agjencia kundër Korrupsionit ka konstatuar se z.Shala ka funksione menaxhues në dy biznese private (D.P.T. “Penthouse” dhe “Delta Guri” sh.p.k.).

Prandaj, Agjencion kundër Korrupsionit ka kërkuar nga zyrtari i lartë z.Shala që; përderisa ushtron funksionin e zyrtarit të lartë (aktualisht Këshilltar komunal) nuk mund të ushtroj funksion menaxhues në ndërmarrje private, edhe pse z.Shala ka dekluar se ato aktualisht nuk janë aktive. Megjithatë ai është këshilluar që të bëjë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit nga zyrtari i lartë z.Shala ka pranuar informacion me shkrim se ka bërë shuarjen vullnetare të biznesit DPT “Penthause”, të lëshuar nga ARBK me datën 06.08.2018, e me numër protokoli DPK-03-02-2565/18).

Ndërsa për biznesin “Delta – Guri” sh.p.k. ka iniciuar procedurën e ndryshimeve në biznes. Këtë po ashtu e ka konfirmuar me informatë zyrtare nga ARBK të datës 23.10.2018, në të cilën shihet se tashmë z.Shala ka heq dorë nga funksioni menaxhues në këtë biznes duke emëruar një person të besuar (Z.Arkivë-05-01/3747/18).

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havollli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

